



RAPORTI VJETOR I SIGURISË 2017



DEPARTAMENTI I SIGURISË

Rr. Rustem Statovci, 29 • +383 38 22 00 40 ext 119 • Afim.Mehmetaj@rks-gov.net

28/09/2018

PËRMBAJTJA

A. PARATHËNIE.....	3
1. Qëllimi, fushëveprimi dhe të dhënat tjera të raportit.....	3
B. PJESA HYRËSE	4
6. Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit..	11
C. Organizimi.....	12
1. Prezantimi i organizimit.....	12
D. Zhvillimet në Sigurinë Hekurudhore	14
1. Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë.....	14
Organi i Sigurisë duhet të siguroj që siguria hekurudhore në përgjithësi mirëmbahet, atëherë kur është e arsyeshme dhe e nevojshme të përmirësohet, e gjithë kjo duke marrë parasysh legjislacionin e Kosovës dhe atë të BE-së të përshtatshëm për këtë sektor si.	14
2. Analizimi i detajuar i trendit të të dhënave.....	15
E. Ndryshime të rëndësishme në rregullore, legjislacion dhe dispozita administrative	20
F. Zhvillimi i Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë	21
G. Burimet e Informacionit.....	31
Aneksi A - Struktura e Informacioneve Hekurudhore.....	32
Aneksi B - Struktura Organizative.....	36
Aneksi C.....	40
Shkurtesat:.....	42

A. PARATHËNIE

1. QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE TË DHËNAT TJERA TË RAPORTIT

Obligimi për të përgatitur Raportin Vjetor të Sigurisë (RVS) rrjedh nga dispozita e nenit 20 të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës si dhe nga neni 18 i Direktivës 2004/49/EC për Sigurinë hekurudhore të Bashkimit Evropian (BE). Nga departamenti i Sigurisë kërkohet që të përgatitet dhe të publikohet RVS. Raporti mbulon aktivitetet kryesore të sigurisë e cila përfshinë periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2017. Qëllimi i këtij RVS është që të ofrojë informacion në lidhje me nivelin e sigurisë hekurudhore.

Ky raport i sigurisë për vitin 2017 mbulon aktivitetet e sigurisë të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), respektivisht aktivitetet e departamentit të Sigurisë gjatë vitit 2017, ky është raporti i gjashtë (6) me radhë të cilin e paraqesim te Drejtori i Përgjithshëm dhe te Bordi i ARH-së. Objektivat dhe përmbajtja e raportit janë të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës.

Ky raport i përshkruan aktivitetet e vitit paraprak të departamentit të sigurisë, menaxherit të infrastrukturës (MI) dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore (NH). Informacionet kryesore që i përmban raporti janë:

- a. zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS),
- b. ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregullativ në lidhje me sigurinë hekurudhore,
- b. zhvillimin e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë në Kosovë,
- c. rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e MI dhe të NH,
- d. përjashtimet të cilat nëse vendoset të bëhen nga departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Bashkimi Evropian Agjensioni për hekurudha (ish European Railway Agency- ERA), dhe përmban të gjitha çështjet të cilat janë paraqitur në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.



Fig.1

B. PJESA HYRËSE

1. Hyrje në raport

Raporti Vjetor i Sigurisë përgatitet nga Departamenti i Sigurisë në kuadër të ARH-së, në përputhje me Ligjin 04/L-063 Neni 20 për hekurudhat në Republikën e Kosovës si dhe nenit 18 të Direktivës 2004/49/EC.

Struktura e këtij raporti është në përputhje me rekomandimet (modelit dhe udhëzimit) e Bashkimit Evropian Agjensioni për Hekurudha (ERA).

Raporti i sigurisë përgatitet duke u bazuar në radhë të parë nga informacioni i siguruar nga aktivitetet e departamentit të sigurisë të cilat janë kryer gjatë vitit raportues si dhe nga informatat e raporteve vjetore të:

1.1. Menaxherit të Infrastrukturës (MI)-Infrakos, i cili ka një autorizim të vlefshëm të sigurisë në qe nga janari i vitit 2013.

1.2. Ndërmarrjes Hekurudhore (NH)-Trainkos, e cila ka një certifikatë të vlefshme të sigurisë qe nga janari i vitit 2013.

1.3. Ndërmarrjes Hekurudhore (NH)-Railtrans, e cila ka një certifikatë të vlefshme të sigurisë qe nga tetori i vitit 2016.

2. Shtrirja e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës

Hartat e bashkangjitura (Aneksi A. 1.) tregojnë të gjithë rrjetin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Rrjeti hekurudhor në Republikën e Kosovës është i ndarë në këto linja:

✚ **Linja Veri – Jug** që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s. (Linjë funksionale).

✚ **Linja Verilindje deri në Perëndim e cila përbëhet nga tri degë:**

✚ **Linja Lindore** nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me 45 km gjatësi. Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (Linjë funksionale)Bardhosh-Podujevë 30 km (Linjë jo - funksionale)

✚ **Linja Perëndimore** , Fushë Kosovë-Pejë me 81 km gjatësi (Linjë funksionale),

✚ **Linja Jug-Perëndim**, Klinë-Prizren me 58 km gjatësi.

- Klinë – Xërxe 35 (Linjë funksionale)
- Xërxe – Prizren 23 (Linjë jo-funksionale).

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës më 01.09.2011 është bërë ndarja e Hekurudhave të Kosovës SHA në dy kompani të reja:

✚ Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS SH.A, dhe

✚ Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës TRAINKOS SH.A.

Hekurudhat në Kosovë kanë një histori të gjatë, gjegjësisht në vitin 1874 u ndërtua linja e parë hekurudhore në Kosovë në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Ishte ky fillimi i shtrirjes së rrjetit hekurudhor nëpër Kosovë, aq sa i rëndësishëm për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, po aq i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit. Në

vitin 1931 vazhdoj ndërtimi i kësaj linjës në relacionin Mitrovicë – Leshak, më 1934 ajo Fushë Kosovë – Prishtinë, më 1936 Fushë Kosovë – Pejë, më 1949 Prishtinë – Podujevë – Livadhi dhe më 1963 Klinë – Prizren.

Hekurudhat e Kosovës kanë një shtrirje në territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,951 km linjë e hapur hekurudhore, me një gjatësi prej 105,784 km në stacione dhe 103,4 km linja industriale. Hekurudhat e Kosovës përmes Leshakut dhe Podujevës në veri dhe lindje janë të lidhura me Serbinë, ndërsa përmes Hanit të Elezit, në jug me Maqedoninë.

3. Lista e Menaxherëve të Infrastrukturës (MI) dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore (NH)

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i Menaxherëve të Infrastrukturës që ka një Autorizim të vlefshëm të sigurisë Pjesa A dhe B, si dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore të cilat gjithashtu kanë një Certifikatë të vlefshme të Sigurisë Pjesa A dhe B.

Nr	Emërtimi i kompanisë
1	Menaxheri i Infrastrukturës – Infrakos SH.A.
2	Ndërmarrja hekurudhore – Trainkos SH.A.
3	Ndërmarrja hekurudhore – Railtrans L.L.C.

Fig.2.

4. Analizë e Përgjithshme në zhvillimet e sigurisë hekurudhore, autorizimi / certifikimi i sigurisë, si dhe autorizimi i futjes në shërbim etj).

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat mbi menaxherin e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore të cilat kanë një autorizim të vlefshëm të sigurisë (Infrakos), si dhe një certifikatë të vlefshme të sigurisë (Trainkos dhe Railtrans).

4.1. Menaxheri i Infrastruktures hekurudhore

Nr	Emërtimi i kompanisë	Autorizimi i sigurisë pjesa A dhe B	Aktive
1	Menaxheri i Infrastrukturës (Infrakos)	24.01.2013 24.01.2013	Po Po

Fig.3.

4.2. Ndërmarrjet hekurudhore

Nr	Emërtimi i kompanisë	Certifikata e sigurisë pjesa A dhe B	Aktive
1	Ndërmarrja Hekurudhore (Trainkos)	24.01.2013 24.01.2013	Po Po
2	Ndërmarrja Hekurudhore (Railtrans)	04.10.2016 04.10.2016	Po Po

Fig.4.

Gjatë vitit 2017 kanë ndodhur 17 aksidente dhe incidente, nëse e krahasojmë me vitin 2016 ku kishte 14 aksidente dhe incidente ka një rritje prej 21.42 %.

Numri i personave të cilët të lënduar në vitin 2017 është 17, nëse e krahasojmë me vitin 2016 që ishte 17 pa ndonjë ndryshim kemi numër të njëjtë.

Në vitin 2017 numri i përgjithshëm i viktimave është (3) ne krahasim me vitin 2016 që ishte 1.

Demet materiale ne infrastrukturën hekurudhore gjatë vitit 2017 kane qene 56303.65 € ndërsa ne vitin 2016 janë 6849.25 €.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur në formë tabelore aksidentet dhe incidentet të cilat kanë ndodhur nëpër komuna gjatë viteve 2014-2017.

Ngjarjet e Jashtëzakonshme nëpër komuna për vitet 2014-2017										
	2014		2015		2016		2017		Gjithsejtë	
	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident
Prishtinë	0	2	0	1	0	3	1	3	1	9
Fushë Kosovë	0	3	0	5	0	1	1	2	1	11
Drenas	3	0	0	4	0	1	0	4	2	9
Klinë	0	0	1	1	0	0	0	1	1	2
Pejë	0	1	1	0	0	2	1	3	2	6
Lipjan	0	1	0	1	1	1	0	0	1	3
Ferizaj	0	1	0	1	0	3	0	1	0	6
Kaçanik	0	2	0	0	0	2	0	0	0	4
Hani i Elezit	0	0	0	2	0	0	0	0	0	2
Obiliq	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Vushtrri	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mitrovicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	2	11	2	15	1	13	3	14	8	53
Gjithsej.	13		17		14		17		61	

Fig.5.

Në diagramin e më poshtëm janë paraqitur aksidentet të cilat kanë ndodhur në komunat përkatëse përgjatë viteve 2014-2017. Siç shihet numri me i madh i aksidenteve përgjatë viteve të paraqitura ka ndodhur në komunën e Pejës (2) dhe të Drenasit (2).




Fig.6.

Kurse sa i përket incidenteve numri me i madh ka ndodhur në komunat Fushë Kosovë (11), Prishtinë (9) dhe Drenas (9).




Fig.7.

RAPORTI VJETOR I SIGURISË 2017

Me poshtë janë të paraqitura diagramet për ngjarjet e jashtëzakonshme, të cilat kanë të bëjnë me persona të lënduar, dëmet materiale në hekurudha si dhe personat e vdekur për periudhën pesë vjeçare.

	Nr. i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Nr. i personave të vdekur	Nr. i personave të lënduar	Dëmet materiale në hekurudhat e Kosovës
2013	17	2	17	3327.90€
2014	13	3	14	825.00€
2015	17	2	11	4759.25€
2016	14	1	17	6849.50€
2017	17	3	17	56303.65€

Fig.8.

Në diagramet e më poshtme janë paraqitur numri i aksidenteve të ndodhura në pesë vitet e fundit (2013-2017), ku në vlera numerike dhe % jepet numri i aksidenteve për vitet e cekura.




Fig.9.

Në diagramet e më poshtme janë paraqitur numri i incidenteve të ndodhura në pesë vitet e fundit (2013-2017), ku në vlera numerike dhe % jepet numri i incidenteve për vitet e cekura.




Fig.10.

Sa i përket dëmeve materiale të cila kanë ndodhur gjatë viteve 2013-2017, me poshtë janë të paraqitura në formë të detajuar me grafikone.




Fig.11.

5. Autorizimi i Sigurisë dhe Certifikata e Sigurisë

Ashtu siç parashihet me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës, rregulloren e ARH-së Nr. 04/2017 për metodat e përbashkëta të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë dhe si rregulloren e ARH-së Nr.02/2012 për Certifikatë të sigurisë, po ashtu edhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloret e Komisionit Nr.1169/2010/EU, Nr.1158/2010/EU, parashohin kriteret për dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për MI dhe NH.

Secili MI së shfrytëzimit të përbashkët duhet të merr Autorizimin e Sigurisë, i cili duhet të konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë (SMS), si dhe konfirmon pranimin e dispozitave të MI për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për dizajn, mirëmbajtje dhe operim të sigurt në infrastrukturën hekurudhore, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit, kur është e përshtatshme.

Secila NH që ka një licencë valide duhet të merr Certifikatën e Sigurisë para se t'i jepet e drejta për qasje në një infrastrukturë hekurudhore. Qëllimi i Certifikatës së Sigurisë është të ofroj dëshmi se ndërmarrja hekurudhore ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë (SMS) dhe mund të plotësoj kërkesat e paraqitura në TSI-të dhe në legjislacionin relevant të BE-së, si dhe në rregullat nacionale të sigurisë në ofrimin e shërbimeve për transport të sigurt në rrjetin hekurudhor.

Gjatë viti për të cilin po raportojmë nuk kemi pasur asnjë kërkesë për të marrë autorizim/certifikatë të re apo te rinovuar të sigurisë.

6. Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-063, për hekurudhat në Republikën e Kosovës, neni 18 paragrafi 3.1, 3.3 neni 109, 110 dhe 111 secili mjet lëvizës para se të futet në shërbim duhet të autorizohet nga Departamenti i Sigurisë.

Gjatë vitit 2017 departamenti i sigurisë ka autorizuar një numër të konsiderueshëm të mjeteve lëvizëse, gjithsej janë autorizuar për tu futur në shërbim dhjetë (11) mjete lëvizëse, një lokomotivë dizel-hidraulike në pronësi të Railtrans dhe dhjetë (10) vagonë për transportin e udhëtarëve në pronësi të Trainkos.

RAPORTI VJETOR I SIGURISË 2017

Operatori për transport të mallrave RAILTRANS L.L.C. me datë: 21.02.2017 ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për Lokomotivën dizel hidraulike për transport të mallrave me numër serik 55231-5.

Me datë: 12.02.2017, Railtrans ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të lokomotivës dizel-hidraulike me numër serik 55231-5.

Departamenti i Sigurisë pas vlerësimit të dokumentacionit të ofruar nga RAILTRANS L.L.C. si dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe në këtë mënyrë kemi dhënë autorizimin për futjen në shërbim për Lokomotivën për transport të mallrave me Nr. 55231-5, të cekur me lartë.

Me datë: 05.05.2017, kemi dhënë autorizimin për futjen në shërbim për lokomotivën dizel-hidraulike, të Railtrans-it.

Kurse operatori për Operim me Trena të Hekurudhave të Kosovës TRAINKOS SH.A. me datë 20.04.2017 ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për dhjetë (10) vagonë të udhëtarëve.

Me datë: 20.04.2017, Trainkos ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për dhjetë (10) vagonë të udhëtarëve.

Departamenti i Sigurisë pas vlerësimit të dokumentacionit të ofruar nga TRAINKOS SH.A për 10 (dhjetë) vagonët e udhëtarëve si dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kemi vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe në këtë mënyrë Departamenti i Sigurisë ka dhënë autorizimit për futjen në shërbim për këta 10 (dhjetë) vagonë të udhëtarëve me numrat e autorizimit të cekur më lartë.

Me datë: 01.06.2017, kemi dhënë autorizimin për futjen në shërbim për 10 (dhjetë) vagonë të udhëtarëve, në pronësi të Trainkos-it.

C. ORGANIZIMI

1. Prezantimi i organizimit

Ashtu siç është paraparë edhe me Ligjin 04/L-063, nenit 3 paragrafi 1.42. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) të Kosovës – është institucion i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin,

mbikëqyrje, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë dhe i cili vepron si organ licencues, organ përgjegjës për çështjet e interoperabilitetit dhe entiteteve të njoftimit, organ për rregullimin e tregut hekurudhor dhe organin për sigurinë hekurudhore dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji. ARH është themeluar në vitin 2010, në vitin 2017 kishte 17 të punësuar, prej tyre 3 janë në departamentin e sigurisë. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar dhe funksionon nën mbikëqyrjen e ARH për të siguruar që siguria mbahet dhe përmirësohet në sistemin hekurudhor të Kosovës. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore është i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe vendim marrjen në raport me ndonjë Ndërmarrje Hekurudhore, Menaxher i Infrastrukturës, aplikuës apo entitet i prokurimit.

Bazuar në ligjin 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës departamentit përgjegjës për sigurinë hekurudhore i janë besuar detyrat në vazhdim:

- a. autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe kontrollimin që ato operojnë dhe mirëmbahen në përputhje me kërkesat esenciale;*
- b. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;*
- c. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;*
- d. lëshimi, përtëritja, amendamentimi dhe revokimi i pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë, si dhe kontrollimi nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat e paraqitura në to, dhe se MI dhe NH janë duke operuar sipas ligjit në fuqi;*
- e. monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, kornizën rregullative të sigurisë duke përfshirë sistemin e rregullave nacionale të sigurisë;*
- f. mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar;*

g. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore;

h. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës (RINF).

ARH në rolin e autoritetit të sigurisë është gjithashtu pjesëmarrës i rregullt në takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Bashkimi Evropian Agjensioni për Hekurudha (European Union Agency for Railways), si dhe në shumë aktivitete tjera të organizuara si nga SEETO po ashtu edhe nga vendet e tjera.



2. Struktura Organizative e ARH-së është paraqitur në Aneksin B.

D. ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE

1. Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë

Organi i Sigurisë duhet të siguroj që siguria hekurudhore në përgjithësi mirëmbahet, atëherë kur është e arsyeshme dhe e nevojshme të përmirësohet, e gjithë kjo duke marrë parasysh legjislacionin e Kosovës dhe atë të BE-së të përshtatshëm për këtë sektor si.

Në mënyrë që të kemi një mbikëqyrje me efikase organi i sigurisë përdor metodën për qasje ndaj rrezikut. Në planifikimin e aktiviteteve mbikëqyrëse jemi bazuar nga përvoja e raportimit të aksidenteve, incidenteve, inspektimeve si dhe përvojat nga proceset tjera janë përdorur në mënyrë aktive ashtu që prioritetet tona janë fokusuar kryesisht në ato aktivitete për të cilat kemi menduar se paraqesin një rrezikshmëri më të larta.

Mirëmbajtja dhe rritja e nivelit të sigurisë në sektorin hekurudhor në masë të madhe varet edhe nga koordinimi ndërmjet ARH-së, MI dhe NH, për këtë arsye, niveli i sigurisë në hekurudha është përshkruar në formën e objektivave për përmirësimin e sigurisë që janë zbatuar nga të gjitha palët ARH, MI dhe NH.

Duke pasur parasyshë informatat e më sipërme, ne kryesisht fokusohemi në:

- *Rrezikun individual i cili ndërlidhet me udhëtarët, stafin (përfshirë edhe stafin e kontraktuesve),*
- *Rrezikun individual të shfrytëzuesve të vendkalimeve (kryqëzimeve hekurudhë-rrugë) dhe të tjerëve,*
- *Rrezikun individual duke mos paragjykuar rregullat e detyrueshme ekzistuese nacionale dhe rajonale,*
- *Rrezikun individual lidhur me personat e pa autorizuar në objektet hekurudhore,*
- *Riskun social,*
- *Përfshirjen aktive të menaxhmentit të lartë të NH dhe MI të cilët në një formë apo tjetër janë përgjegjës për sigurinë hekurudhore (duke përfshirë vlerësimet e menaxhmentit),*
- *udhëzime të brendshme për vendkalimet dhe pajisjet e sigurisë,*
- *Përdorimi aktiv i analizës së rrezikut (metoda e zakonshme e vlerësimit të rrezikut- CSM RA.)*

Pasi që Menaxheri i Infrastrukturës dhe Ndërmarrjet Hekurudhore janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe rritjen e nivelit të sigurisë në rrjetin hekurudhor të Kosovës, ato duhet të implementojnë Sistemin e tyre për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) në mënyrë që të kontrollojnë rreziqet të cilat mund të shkaktojnë aksidentet dhe incidentet.

Organi përgjegjës për siguri duhet ti merr parasysh të gjitha rekomandimet nga organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore (KHAIA) dhe duhet të sigurojë që NH dhe MI i zbatojnë rekomandimet. Pasi që Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 03.10.2017. ka emëruar Hetuesin e Aksidenteve Hekurudhore në kuadër të KHAIA-së, ne në vitet në vazhdim presim që të kemi rekomandime të sigurisë nga ky organ, mirëpo deri me tani nuk kemi pasur asnjë rekomandim të sigurisë nga KHAIA.

2. Analizimi i detajuar i trendit të te dhënave

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat mbi vlerësimin e arritjes së qëllimeve të përbashkëta të sigurisë (QPS) të zhvilluara në BE, Organi përgjegjës për sigurinë duhet të mbledhë informacion për treguesit e përbashkët të sigurisë (TPS) nëpërmes të raporteve vjetore të Menaxherit të Infrastrukturës (Infrakos) si dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore (Trainkos dhe Railtrans) siç është përcaktuar me ligjin për hekurudhat e

Kosovës Nr.04/L-063 dhe direktivës së sigurisë 2004/49/EC, ku si referencë i kemi paraqitur të dhënat për pesë vitet e fundit 2013-2017.

Numri i aksidenteve dhe incidenteve

2013	2014	2015	2016	2017
17	13	17	14	17

Fig.12.

Siq mund të shihet në figurën e më sipërme numri i aksidenteve dhe incidenteve në vitin 2017 ishte 17, ku në krahasim me vitin paraprak 2016 ka një rritje prej 21.40 %, ne vitin 2016 ishte 14.

Numri i të vdekurve

2013	2014	2015	2016	2017
2	3	2	1	3

Fig.13.

Në vitin 2017 ka një rritje të numrit të të vdekurve si pasojë e aksidenteve të cilat kanë ndodhur, numri i të vdekurve në 2017 ishte tre qe në krahasim me vitin 2016 ka rritje për dy (2) të vdekur.

Numri i të lënduarve

2013	2014	2015	2016	2017
17	14	11	17	17

Fig.14.

Pra numri i personave të cilët ishin të lënduar gjatë vitit 2017 është 17, në krahasim me vitin 2016 kemi numër të njëjtë të të lënduarve qe ishte poashtu 17.

Në vazhdim janë të paraqitura të dhënat e plota për trendin e ngjarjeve në vitin 2017.

- 17 Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme
- 3 (tre) qytetarë kanë vdekur si pasojë e aksidenteve.
- 0 të vdekur si pasojë e vetëvrasjes
- 17 qytetarë kanë pësuar lëndime.
- 0 ka qenë numri i tentimit për vetëvrasje

Viti	Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Të vdekur si pasojë aksidenti	Të Vetëvrarë	Të lënduar	Tentim vetëvrasje
2017	17	3	0	17	0

Fig.15.

Gjatë vitit 2017 kompania Trainkos ka realizuar gjithsejtë 3950 trena të udhëtarëve, kurse në vitin 2016 ka pasur 5148 trena të udhëtarëve, pra ka pasur një rënie prej 1198 trenave të udhëtarëve. Kjo ka ndodhur si pasojë e revokimit të trenave nga ana e operatorit Trainkos, për shkak të mos pagesës së kontratës për shërbimeve publike nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës. Numri i kilometrave të kaluar të trenave të udhëtarëve gjatë vitit 2017 ishte 203809.20 km, ndërsa në vitin 2016 ishte 282249.00 km, pra ka një rënie prej afërsisht 28% në krahasim me vitin paraprak.

Kurse sa i përket transportit të mallrave situata ka qenë dukshëm më e mirë, pasi që gjithësejt ka pasur 2189 trena, ku Trainkos ka realizuar 1947, kurse railtrans 242 trena të mallrave. Në vitin 2016 kishte gjithsejtë 1435 trena të mallrave, pra ka një rritje prej 52.50% të numrit të trenave.

Gjatë vitit 2017 kishte të kaluar gjithësejt 57497.10 km të trenit të mallrave, ku Trainkos ka realizuar 51096.70 km, kurse Railtrans ka realizuar gjithësejt 6400.40 km. Në vitin 2016 kishte gjithsejtë 35934.5 km të kaluara, ku nëse i krahasojmë del se në vitin 2017 kishte një rritje prej afërsisht 40% krahasuar me vitin 2016.

Viti	Kilometrat e kaluara të trenit të udhëtarëve	Kilometrat e kaluara të trenit të mallrave
2013	281931.60	114430.60
2014	281986.00	120014.00
2015	282079.00	105378.20
2016	282249.00	35934.50
2017	203809.20	57497.10

Fig.16.




Fig.17.

Rezultatet e rekomandimeve të sigurisë

Departamenti i sigurisë edhe gjatë vitit 2017 nuk ka pranuar asnjë rekomandim i cili ka të bëjë me sigurinë nga organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore (KHAIA).

Rekomandimet e sigurisë hekurudhore duhet të përgatitën dhe shpërndahen nga Organi për Hetimin e Aksidenteve (KHAIA).

3. Zhvillimet në sigurinë hekurudhore janë paraqitur në aneksin C



Fig.18.



Fig.19.

E. NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË RREGULLORE, LEGJISLACION DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Me qëllim që të harmonizohet korniza ligjore e sektorit hekurudhor në Kosovë me ato të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, Parlamenti i Kosovës me datë 14.11.2011 ka miratuar Ligjin Nr. 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës (ku ligj ka hyrë në fuqi me 01.01.2012), në të cilin ligj janë transponuar plotësisht nga *acquis* e BE-së direktiva 2004/49; direktiva 2001/14, direktiva 91/440 dhe 95/18, direktiva 2007/59 dhe direktiva 2008/57 dhe pjesërisht direktiva 2012/34.

Për kryerjen e detyrave sipas ligjit për hekurudhat e Kosovës, struktura e ARH-së, përfshinë: menaxhmentin, departamentet dhe personelin mbështetës. çdo departament ka funksione të përcaktuara për t'iu përgjigjur nevojave të mobilitetit të shoqërisë, transportit dhe ekonomisë, siç janë të rregulluara më këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nevojshme që nxjerrin vetë departamentet dhe menaxhmenti i ARH-së.

Departamentet në kuadër të ARH-së janë:

- *Departamenti i Sigurisë,*
- *Departamenti i Rregullimit të Tregut,*
- *Departamenti i Interoperabilitetit,*
- *Departamenti i Licencimit.*

Të gjitha të dhënat lidhur me ndryshimet në legjislacion, rregullore dhe dispozita administrative mund ti gjeni në ueb faqen e ARH: www.arh-ks.org

Departamenti i Sigurisë gjatë kësaj periudhe raportuese pra gjatë vitit 2017 ka përgatitur dy rregullore të cilat janë miratuar nga Bordi i ARH-së.

1. Rregullore Nr. 04/2017 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore.
2. Rregullore Nr. 05/2017 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut.

Këto dy rregullore janë përgatitur me qëllim të përmirësimit të procedurave për: marrjen e autorizimit të sigurisë për menaxher të infrastrukturës si dhe rregullorja për metodat e përbashkëta të sigurisë për vlerësimin dhe llogaritjen e rrezikut.

F. ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË

1. Legjislacioni nacional - data e aplikimit - disponueshmëria

Lëshimi i certifikatës dhe autorizimit të sigurisë bëhet në pajtim me nenin 94, nenin 104 të ligjit 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, nenit 10 dhe 11 të Direktivës 2004/49/EC.

Pas përgatitjes së të gjitha akteve nënligjore të domosdoshme për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë siç janë:

- Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2012 për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë,
- Rregullore e ARH-së Nr. 02/2012, për dhënien e certifikatës së sigurisë,
- Rregullore e ARH-së Nr. 04/2017 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore,
- Rregullore e ARH-së Nr. 06/2012 për regjistrimin e infrastrukturës.

Departamenti i sigurisë me datë:

26.11.2012, nga NH (Trainkos) ka pranuar aplikacionin për marrjen e certifikatës së sigurisë,

12.12.2012, nga MI (Infrakos) ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit të sigurisë, si dhe

02.02.2016, nga Railtrans ka pranuar aplikacionin për marrjen e certifikatës së sigurisë.

Në përputhje me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës si dhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloren e Komisionit 1169/2010, Rregulloren 1158/2010, të cilat parashohin dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për MI dhe NH.

Menaxheri i infrastrukturës Infrakos ka një autorizim valid të sigurisë pjesa A dhe B prej 24.01.2013, Ndërmarrja hekurudhore Trainkos ka një certifikatë valide të sigurisë pjesa A dhe B prej 24.01.2013, kurse ndërmarrja hekurudhore private Railtrans ka një certifikatë valide të sigurisë pjesa A dhe B prej 04.10.2016.

Gjatë vitit 2017 nuk kemi pasur asnjë aplikacion apo kërkesë për marrjen e autorizimit apo certifikatës së sigurisë pjesa A dhe B.

2. Mbikëqyrja e implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) nga MI dhe NH

Bazuar në ligjin Nr. 04/L-063, neni 94 paragrafi 3, neni 100 paragrafët 1,2,3,4 dhe neni 103 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, Rregullores së ARH-së Nr. 03/2013 Metodën e Përgjithshme e Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë, Direktivës së sigurisë 2004/49/EC nenet 4, 9 dhe aneksi III. Departamenti i Sigurisë ka filluar dhe përfunduar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore Trainkos dhe Railtrans.

Gjate këtij procesi jemi munduar që të përfshijmë të gjithë personat përgjegjës të cilët në një apo formë tjetër janë përgjegjës edhe për çështje të sigurisë dhe implementim të SMS në kompaninë Infrakos, Trainkos dhe Railtrans. Gjate mbikëqyrjes së implementimit të SMS kemi mbajtur takime pothuajse me të gjithë personat përgjegjës për sigurinë nga Infrakos, Trainkos dhe Railtrans. Nga ana e kompanive jemi njoftuar se e kanë bërë shpërndarjen e manualit të SMS tek të gjitha departamentet dhe sektorët përkatëse, si dhe janë mbajtur trajnimet të duhura për të shpjeguar se cilat janë detyrat dhe obligimet që rrjedhin nga SMS. Kurse lidhur me testimin e përmbajtjes së alkoolit në gjak të personave përgjegjës gjatë transportit zyrtarët e tre kompanive na kanë informuar se deri me tani nuk e kanë aplikuar një praktikë të këtillë, por kanë kryer kontrole rutinore ditore para fillimit të punës për personat përgjegjës të sigurisë, e sidomos të makinistët, ndihmës makinistët, dispeçerët, si dhe personave të tjerë të cilët me punën e tyre kanë ndikim direkt ose indirekt në rritjen e nivelit të sigurisë.

Në fund të procesit ne kemi përgatitur nga një raport me rekomandime për secilën kompani veç e veç, në vazhdim po i paraqesim disa nga rekomandimet për të cilat kemi menduar se janë me të rëndësishme.

Rekomandimet e më poshtme janë ato të cilat i kemi dërguar të kompanitë Infrakos, Trainkos dhe Railtrans dhe ju drejtohen të vlejné të gjithë sektorëve dhe të gjitha nivelet e menaxhmentit.

1. Menaxhmenti i kompanive duhet të jetë i përkushtuar që politikën e sigurisë, SMS dhe Deklaratën e Konformitetit të implementohen në tërësi ashtu siç janë paraparë në Manualin e SMS,
2. Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë duhet të dokumentohet në të gjitha pjesët relevante dhe të përshkruaj ndarjen e rolit dhe përgjegjësi, llojin e shërbimeve, vlerësimin e rrezikut etj. siç e keni paraqitur në deklaratën FO_DC_05,

3. Auditimi (monitorimi) duhet të kryhet dhe të dokumentohet në baza të rregullta ashtu siç e keni paraparë në deklaratën e konformitetit FO_DC_19,
4. Organizimi i trajnimit (shkollimit) për SMS dhe deklarata të konformitetit të vazhdohet edhe në të ardhmen gjitha nivelet e kompanive, për personat përgjegjës për siguri. Personat përgjegjës për shkollim së bashku me menaxherët e secilit sektor do të mund të organizonin trajnimin për stafin e tyre, por gjithmonë me pjesëmarrjen aktive të zyrtarit kryesor të SMS,
5. Të vazhdohet me zbatimin e përpiktë të rregullores për mbrojtjen në punë.
6. Të vendosen kutia e sugjerimeve në stacione për stafin përgjegjës për çështje të sigurisë.
7. Të pajiset me aparat kundër zjarrit tek të gjitha mjetet e mirëmbajtjes, objektet dhe stacionet.
8. Të ketë një kontroll dhe evidentim të rregullt ditor për përmbajtjen e alkoolit në gjak, kjo vlen për të gjithë personat përgjegjës të cilët mund të ndikojnë në rritjen e sigurisë në hekurudhat e Republikës së Kosovës (makinistët, ndihmës makinistët, konduktorët, dispeçerët, personat e mirëmbajtjes etj).

Pra qëllimi i mbikëqyrjes së implementimit të SMS ka qenë që të sigurohemi se Infrakos, Trainkos dhe Railtrans e kanë vendosur Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe ky sistem plotëson kërkesat e sigurisë dhe përmban elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor në Kosovë.

2.1. Inspektimi i linjave hekurudhore

Gjatë vitit 2017 departamenti i sigurisë ka bërë inspektimin e infrastrukturës hekurudhore të të gjitha linjave ekzistuese funksionale dhe jo funksionale.

Linjat funksionale të inspektuara janë:

1. Prishtinë-Fushë Kosovë, (05.09.2017)
2. Fushë Kosovë-Pejë, (27.10.2017)
3. Fushë Kosovë-Hani i Elezit, (20.10.2017)
4. Fushë Kosovë-Miradi, (09.09.2017)

Linjat jo-funksionale të inspektuara janë:

1. Prishtinë-Podujevë, (12.10.2017)

2. Fushë Kosovë-Mitrovicë, (18.10.2017)
3. Klinë-Prizren, (19.09.2017)

2.1.1 Ne vazhdim po e paraqesim disa pjese te raporteve te linjave te cilat janë funksionale dhe atyre te cilat janë jashtë funksionit.

2.1.2. Linjat Funksionale

Gjatë viti 2017 Departamenti i Sigurisë ka inspektuar të gjitha linjat hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore Infrakos.

Në këtë raport i gjeni të gjeturat gjatë inspektimit të këtyre linjave hekurudhore, të gjitha të gjeturat duhet të konsiderohen si rekomandime për linjën e inspektuar e cila është në përdorim për transport hekurudhor.

1. RAPORTI I INSPEKTIMIT TË LINJËS PRISHTINË-FUSHË KOSOVË

Informatat e paraqitura në këtë raport janë siguruar nga inspektimi i kryer nga Departamenti i Sigurisë si dhe informatat e ofruara nga përfaqësuesit e Infrakos-it.




Fig.1



Fig.2



Fig.3




Fig.4

Ashtu edhe siç mund të shihet foto e më sipërme, gjendja e infrastrukturës hekurudhore ne stacionin hekurudhor te Prishtinës nuk ka ndonjë ndryshim të theksuar krahasuar me vitin paraprak. Sistemi i sinjalizimit në hyrje dhe dalje të stacionit është jashtë funksionit, ndriçimi ne stacion pjesërisht funksional, traversat janë ne gjendje te mirë, shtresa e balastit e është mjaftueshme, ndërrueset janë të vajosura, mirëmbajtja afër binarëve e mirë dhe platforma e stacionit këtë vit është shënuar.



Fig.5



Fig.6

Ne këto fotografi shihet vendkalimi ilegal i cili gjendet afër kilometrit (125+120), siç shihet ne fotografi vendkalimi është i pajisur me shenja te rrezikut ne njëren anë kurse në anën tjetër shenja e kryqit te Andreut ka rënë poshtë shtyllës vertikale.



Fig.7



Fig.8

Ne këto fotografi shihet vendkalimi ilegal i cili gjendet afërsisht ne kilometrin (125+200), ashtu edhe siç shihet ne foto vendkalimi është i pajisur me shenjen STOP, krahasuar me vitin paraprak ky vendkalim është pajisur me shenja në te dy anët e rrugës.



Fig.9



Fig.10

Në foto e më sipërme shihet vendkalimi legal i cili gjendet ne zonën industriale, vendkalimi është i pajisur me shenjat STOP në te dy anët e rrugës dhe me Kryqin e Andreut vetëm në njërën ane te rrugës. Ne këtë vendkalim frekuentojnë numër i madh i automjeteve, kjo rrugë lidhe disa zona te banimit me qytetin dhe paraqet rrezik gjatë kalimit mjeteve lëvizëse rrugore prandaj konsiderojmë që ky vendkalim duhet te pajiset me te gjitha shenjat e rrezikut si dhe me rampe mbrojtëse (barrierë).



Fig.11



Fig.12

Ne këto fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet afërsisht ne kilometrin (127+800), ky vendkalim është legalizuar, i njëjti vitin paraprak ishte ilegal. Ky vendkalim duhet te pajiset me të gjitha shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës.



Fig.13



Fig.14

Ne fotot e më sipërme shihet vendkalimi legal i cili gjendet ne rrugën Hajrullah Zymi, vendkalimi është i pajisur me shenja të rrezikut vetëm ne njërën anë te rrugës. Ky vendkalim duhet te pajiset me shenja te rrezikut në te dy anët e rrugës si dhe te vendoset rampa mbrojtëse për shkak se ky vendkalim shfrytëzohet nga një numër i madh i mjeteve lëvizëse të komunikacionit rrugor dhe paraqet rrezik për te gjithë pjesëmarrësit ne komunikacion.



Fig.15



Fig.16

Ne këto foto shihet vendkalimi legal i cili gjendet ne rrugën Pajazit Islami, vendkalimi është i pajisur me shenja të rrezikut vetëm ne njërën anë te rrugës. Me qëllim te rritjes se sigurisë gjate lëvizjes ky vendkalim duhet te pajiset me te gjitha shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës.



Fig.17



Fig.18

Në foton e më sipërme shihet vendkalimi legal i cili gjendet ne rrugën Fehmi Lladrovci. Në këtë vendkalim ne njërën anë te rrugës mungon shenja e ndalimit STOP, kurse shenjat tjera te rrezikut janë të vendosura në te dy anët e rrugës. Me qenë se në këtë vendkalim qarkullojnë numër i madh i automjeteve dhe këmbësoreve vendkalimi duhet te pajiset me rampe mbrojtëse (barrierë).



Fig.19



Fig.20

Ne këto foto shihet gjendja e stacionit hekurudhorë në Fushë Kosovë, siç shihet platforma e stacionit është e shenjëzuar, shtresa e balastit është e mjaftueshme, traversat ne gjendje të mirë, elementet e ndërrueseve dallëndyshja dhe jastëkët janë te vajosura te të gjitha ndërrueset, shenjat për kufizim dhe mbarim te kufizimit te shpejtësisë janë te vendosura ne hyrje dhe dalje te stacionit, ndriçimi ne stacion funksional.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur inspektimet e linjave të cilat janë realizuar gjatë viti 2017.

Inspektimet e linjave hekurudhore gjatë vitit 2017		Fushë Kosovë Medvec Magure	Prishtinë Fushë Kosovë	Fushë Kosovë Hani i Elezit	Fushë Kosovë Pejë	Prishtinë Podujevë	Fushë Kosovë Mitrovicë	Klinë Prizren
Numri i Inspektimeve	Planifikuara	1	1	1	1	1	1	1
	Pa Planifikuara	0	0	0	0	0	0	0
	Realizuara	1	1	1	1	1	1	1

Fig.20.

2.2. Inspektimi i mjeteve lëvizëse

Gjate vitit 2017 departamenti i sigurisë ka bere inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore te cilat janë në menaxhim të: Infrakos, Trainkos dhe Ferronikelit.

2.2.1. Inspektimi i mjeteve lëvizëse të Infrakos

Departamenti i Sigurisë në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore të parapara me Ligjin nr. 04/L-063 neni 104 paragrafi 5, si dhe në përputhje me planin e punës për vitin 2017, kemi paraparë Inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore.

Gjatë viti 2017 Departamenti i Sigurisë ka inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore Infrakos.

Janë inspektuar këto mjete lëvizëse:

1. Pllaser & Theurer,
2. Atlas,
3. Robel,
4. Iveco Daily,
5. Vagon Matës,
5. Vagon Bot Cisterna,
6. Motor i lehtë hekurudhorë,
7. Vagon sallon pune,
8. Rimorkio e hapur,
9. Rimorkio për saldim,
10. Matës për profil të tuneleve,
11. Valterë

Me poshtë po e paraqesim inspektimin e një mjeti lëvizës Pllaser&Theurer



Nga inspektimi kemi vërtetuar se Pllaser & Theurer në fig. 1, me Nr. 99 00 9425 004-2, është në funksion (në përdorim), trashësia e rrotave brenda parametrave të lejuar (sipas pamjes vizuale), karrocëria në gjendje të mirë, sistemi i ndriçimit funksional, xhamat dhe fshesat në gjendje të mirë, Pllaseri është i pajisur me sistemin kundër zjarrit, buria dhe radio lidhja funksionale, lidhëset e ajrit në gjendje të mirë.

2.2.2. Inspektimi i mjeteve lëvizëse te Trainkosit

2.2.2.1.inspektimi i vagonëve te mallrave te Trainkos-it

Gjatë viti 2017 Departamenti i Sigurisë ka inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse në menaxhim të operatorit hekurudhor Trainkos.

Mjetet lëvizëse të inspektuara janë:

1. Lokomotivat,
2. Lokomotivat manovruese,
3. Trenat motorik, si dhe
4. Vagonët e udhëtarëve

Me poshtë po e paraqesim inspektimin e një mjeti lëvizës-Lokomotivë

Lokomotiva me Nr. 92 00 2620 005-4, është në funksion (në përdorim), trashësia e rrotave brenda parametrave të lejuar (sipas pamjes vizuale), karrocERIA në gjendje të mirë, sistemi i ndriçimit funksional, xhamat në gjendje pjesërisht të mirë (xhamat anësor dhe të përparmë janë të krisur), lokomotiva është e pajisur me sistemi kundër zjarrit, buria dhe radio lidhja funksionale, lidhëset e ajrit në gjendje të mirë.



Janë inspektuar:

- Trashësia e rrotave
- Dimensionet i profilit të rrotave
- Sistemi i frenimit
- Papuçet e frenimi (disk)
- Sistemi i ndriçimit
- Pajisjet kundër zjarrit
- Buria dhe Radio Lidhja
- KarrocERIA e mjetit lëvizës
- Lidhëset e ajrit dhe Çengeli
- Xhami i përparmë dhe anësor dhe fshesat e xhamit të përparmë etj.

Numri i inspektimeve të mjeteve levizese gjatë vitit 2017

Inspektimi i llojeve të mjeteve levizese		Lokomotivë	Lokomotivë Manovruese	Tren motorik	Vagonë të udhëtarëve
Numri i Inspektimeve	Planifikuara	1	1	1	1
	Pa Planifikuara	0	0	0	0
	Realizuara	1	1	1	1

Fig.21.

G. Burimet e Informacionit

Raporti vjetor i sigurisë për vitin 2017, është përgatitur bazuar në aktivitetet e departamentit të sigurisë gjatë vitit të lartë përmendur si dhe nga raportet e sigurisë të Infrakosit dhe Trainkosit dhe Ferronikelit.

Menaxheri i Infrastrukturës	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Infrakos Sh.A	26.06.2017

Ndërmarrja hekurudhore (NH)	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Trainkos Sh.A	26.06.2017

Ndërmarrja hekurudhore (NH)	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Railtrans	28.06.2017

ANEKSI A - STRUKTURA E INFORMACIONEVE HEKURUDHORE

A.1 Harta e rrjetit hekurudhor




Fig.22.




Fig.23.



Fig.24.

A.2 Lista e menaxherëve të infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjeve hekurudhore (NH)

A2.1 Menaxheri i Infrastrukturës

Emri	Adresa	Web faqja	Autorizimi i Sigurisë A-B (datë/numër)	Data e fillimit të aktivitetit komercial	Gjatësia e përgjithshme e linjës/gjerësia
Infrakos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.infrakos.com	24.01.2013 KS 21 2013 001 KS 22 2013 001	23.12.2005	333.451/1435

Fig.25.

A.2.2. Ndërmarrja Hekurudhore

Emri	Adresa	Web faqja	Certifikata e Sigurisë A-B (datë/numër)	Data e fillimit të aktivitetit komercial
Trainkos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.trainkos.com	24.01.2013 KS 11 2013 001 KS 12 2013 001	16.08.2011

Fig.26.

A.2.3. Ndërmarrja Hekurudhore

Emri	Adresa	Web faqja	Certifikata e Sigurisë A-B (datë/numër)	Data e fillimit të aktivitetit komercial
Railtrans	Ish fabrika e Amortizatorve terminali doganor Republika e Kosovës	www.railtrans.biz	04.10.2016 KS 11 2016 001 KS 12 2016 001	06.05.2008

Fig.27.

ANEKSI B - STRUKTURA ORGANIZATIVE

B.1. Grafiku: Organizimi i brendshëm i ARH-së gjatë vitit 2017 ishte si më poshtë.




Fig.28.

B.2. Grafiku: Rrjedha Organizative (marrëdhëniet) ndërmjet Autoritetit Rregullativ të hekurudhave (ARH) me organet e tjera kombëtare.




Fig.29.




Fig.30.




Fig.31.




Fig.32.




Fig.33.

ANEKSI C.

C.1. Definicionet e zbatueshme në pajtim me ligjin 04/L-063 për hekurudhat e Kosovë dhe Rregulloren Nr 2003/91/EC

Person i vrarë

Do të thotë çdo person i vrarë menjëherë ose vdekur brenda 30 ditëve, si rezultat i një aksidenti, me përjashtim të vetëvrasjeve;

Person i plagosur rëndë

Nënkupton çdo person i plagosur i cili është shtruar në spital për më shumë se 24 orë, si pasojë e një aksidenti, duke përjashtuar tentim vetëvrasjet;

Km-Udhëtarëve

Nënkupton njësinë e masës që përfaqëson transportin e një udhëtari me hekurudhë gjatë një distancë prej një kilometri. Vetëm distanca në territorin kombëtar të raportimit Vendi do të merren parasysh;

Vetëvrasje

Nënkupton aktin me dashje të lëndojë veten duke rezultuar në vdekje, regjistruar dhe klasifikuar si i tillë nga autoriteti kompetent kombëtar;

Aksidenti

Nënkupton ngjarjen e padëshirueshme dhe të paqëllimtë apo zinxhirin specifik të ngjarjeve të tilla të cilat kanë pasoja dëmtuese;

Aksidenti serioz

Nënkupton ndonjë ndeshje apo rrëshqitje të trenave që rezulton në vdekjen e të paktën një personi apo lëndimet serioze të së paku pesë apo më shumë personave apo dëmtim të gjerë të mjeteve lëvizëse hekurudhore, infrastrukturës dhe mjedisit apo ndonjë aksident tjetër i ngjashme me ndikim të dukshëm në rregulloren e sigurisë hekurudhore apo në menaxhimin e sigurisë;

Incidenti

Nënkupton ndonjë ndodhi tjetër nga aksidenti apo aksidenti serioz që shoqërohet me operimin e trenave dhe që ka efekt në sigurinë e operimit;

Treni

Nënkupton kompozicionin e mjeteve lëvizëse hekurudhore duke përfshirë këtu edhe tërheqjen;

Vendkalimi

Nënkupton kryqëzimin e vijës hekurudhore me infrastrukturën rrugore në të njëjtin nivel.

SHKURTESAT:

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
ERA	European Railway Agency
MI	Menaxheri i Infrastrukturës
NH	Ndërmarrja Hekurudhore
SMS	Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë
RVS	Raporti Vjetor i Sigurisë
TPS	Treguesit e Përbashkët të Sigurisë
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
RINF	Regjistri i Infrastrukturës
MPS	Metodat e Përbashkëta të Sigurisë
TSI	Technical Specifications for Interoperability
STI	Specifikat Teknike për Interoperabilitet
BE	Bashkimi Evropian
RVS	Raporti Vjetor i Sigurisë
SEETO	South East Europe Transport Observatory
QPS	Qëllimet e Përbashkëta të Sigurisë